STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 21 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) DERGON ANETARE TE QEVERISE PER TE SHPERNDARE DHURIMET E LODRAVE PER KRISHTLINDJE NE KOMUNITETET E GODITURA ME RENDE NGA URAGANI SENDI (SANDY)

Mbi 48,000 lodra te dhuruara nga Fondacioni i Industrisë së Lodrave, korporata private dhe banorë të Nju Jorkut (New Yorkers)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) dërgoi sot anëtarë të qeverisë së tij për të bashkërenduar shpërndarjen e mbi 48,000 lodrave të dhuruara për familjet e Nju Jorkut (New York) në zonat e goditura më rëndë nga Uragani Sendi (Sandy). Sot, Presidenti dhe CEO i Zhvillimit të Empire State Keneth Adams, Komisioneri për Rinovimin e Shtëpive & Komunitetit të NYS Derrël Tauns dhe Sekretari i Shtetit Sezar Perales vizituan vendndodhje në Stejtën Ajlënd (Staten Island), Far Rokëuej (Far Rockaway) dhe Qarkun Naso (Nassau County) për të ndihmuar në shpërndarjen e lodrave.

"Për shumë familje në zonat më të shkatërruara nga Uragani Sendi (Sandy), është një kohë e vështirë për të festuar këtë sezon të festave," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Por me bujarinë e Fondacionit të Industrisë së Lodrave, korportatave tona partnere dhe banorëve individualë të Nju Jorkut (New Yorkers), mbi 48,000 lodra janë mbledhur për të ndriçuar festat për fëmijët e prekur nga stuhia."

"Ndërsa familjet e Nju Jorkut (New York) janë ende duke u rimëkëmbur nga super stuhia Sendi (Sandy), të ngroh zemrat të dish se fëmijët ende mund të marrin pjesë në gëzimin e sezonit të festave dhe t'i japin krahë imagjinatës së tyre me lodra të reja," tha Sekretari i Shtetit i Nju Jorkut (New York) Sezar Perales (Cesar Perales). "Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për këtë përpjekje dhe falënderoj udhëheqësit e korporatave tona për dhurimet bujare të tyre."

"Guvernatori Kuomo (Cuomo) ka qënë një udhëheqës në kaq shumë aspekte të ndihmës për Uraganin Sendi (Sandy)," tha Komisionerja e Zyrës së Shërbimeve të Përgjithshme Roen Destito (RoAnn Destito). "Jemi të gëzuar që ishim në gjendje të përdornim ndërtesat e zyrave shtetërore si një pike grumbullimi për shumë punonjës shtetërorë dhe anëtarë të komunitetit anembanë shtetit që dëshironin të dhuronin lodra për të ndihmuar në bërjen e sezonit të festave më të lehtë për familjet që humbën gjithshka në stuhi."

Prej dhurimeve, Fondacioni i Industrisë së Lodrave siguroi 40,000 lodra, të cilat u shpërndanë në organizata anembanë rajonit të prekur në pjesën e poshtme të shtetit. Mbi 8,000 lodra u dhuruan nga Walmart, Sears, PSE&G e Carnegie Hall dhe nëpërmjet fushatës së lodrave të Guvernatorit Nju Jorku Jep (NY Gives) në ndërtesat e zyrave shtetërore dhe Komitetit Demokratik të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Democratic Committee). Përveç kësaj, Toys-R-Us dhuroi 50 karta dhuratash me vlerë 100 dollarë secila, për një dhurim gjithsej prej 5,000 dollarë. Këto dhurime do të dorëzohen në vendndodhje të ndryshme në Qytetin e Nju Jorkut (New York City) dhe Long Ajlënd (Long Island) për shpërndarje.

"Fondacioni i Industrisë së Lodrave është i gëzuar që është ne gjendje të ndajë gëzimin e lodrave dhe të lojës me fëmijët në nevojë në rajonet pranë nesh," tha Xhin Batlër (Jean Butler), Drejtore Ekzekutive, Fondacioni i Industrisë së Lodrave, krahu bamirës i industries së lodrave të Amerikës së Veriut. "Shumë komunitete vendore ende janë duke u rimëkëmbur nga Uragani Sendi (Sandy) dhe shpresa jonë është se këto lodra do të ndihmojnë në rikthimin e njëfarë normaliteti në jetën e tyre të përditshme dhe të ndihmojnë që t'i bëjnë festat pak më të shndritshme."

Dejv Deli (Dave Daly), Zëvendës/President i PSE&G, tha, "PSEG e Long Ajlënd (Long Island) është e gëzuar të bashkohet me këtë përpjekje për t'a bërë sezonin e festave pak më të ndritshëm për familjet -- dhe veçanërisht fëmijët -- që ende ndjejnë ndikimin e Urganit Sendi (Sandy). Përgëzojmë Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe personelin e tij për organizimin e kësaj fushate."

Lu D'Ambrosio (Lou D'Ambrosio), CEO dhe President i Sears Holdings, tha, "Gjatë kësaj kohe të veçantë të vitit, mendojmë për familjet dhe veçanërisht fëmijët e goditura më rëndë nga Uragani Sendi (Sandy). Jemi të kënaqur që dhurojmë lodra për njëfarë gëzimi të festave dhe buzëqeshje për shumë fëmijët që u prekën. Sears mbetet e përkushtuar plotësisht për të ndihmuar komunitetet dhe konsumatorët tanë gjatë kësaj periudhe të vështirë të rimëkëmbjes. Falënderojmë Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për drejtimin e kësaj iniciative."

"Ato familje të prekura nga Sendi (Sandy) mbeten në zemrat dhe mendjet tona, veçanërisht gjatë festave," tha Xhuli Mërfi (Julie Murphy), Zëvendës/Presidente e Lartë e Walmart. "Te Walmart, do të vazhdojmë të bëjmë pjesën tonë për të ndihmuar në përpjekjen e rimëkëmbjes dhe shpresojmë se ky dhurim lodrash do të sjellë pak gëzim për mbi një mijë fëmijë vendas. Falënderojmë Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen e tij të vazhdueshme gjatë kësaj kohe dhe e vlerësojmë mundësinë për të dhënë një dorë ndihmë."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian